



Në mbështetje të nenit 11 dhe nenit 24 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27/2008, nenit 10, 40, 57 paragrafit 1.1 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.10.2022 merr këtë:

V E N D I M

Për ri-alokim dhe transfer të mjeteve buxhetore për vitin 2022

1. **MIRATOHET** Vendimi për ri-destinimin e mjeteve buxhetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2022 në shumën prej 125,608.65 €, në këto kategori të cekura më poshtë:
2. **Nga transferi i mjeteve në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale, fondi burimor (10):**
 - 2.1. Nga programi Zhvillimi Ekonomik (480), nën programi Planifikimi i zhvillimit ekonomik (48011), kodi funksional (0411), në fondin burimor (10), nga projekti: **Investime ne zonën ekonomike ne Apterush** kodi i projektit (45690), shuma prej 30,000.00 €, dhe nga projekti **Investime në turizëm dhe shtigjet e ecjes** kodi i projektit (48159) shuma prej 16,873.50 €
 - 2.1.1 Të transferohen në programin Buxhet dhe Financa (175), nën programi Buxhetimi (17511), kodi funksional (0112), në fondin burimor (10), në projektin: **Projekte me donator (Helvetas)** kodi i projektit (40791), shuma prej 46,873.50 €,
3. **Nga ri-alokimin e mjeteve në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale, në shumë prej 48,735.15 € fondi burimor (10):**
 - 3.1 Brenda programit Arsimi dhe shkanca (920), nën programi Administrata (92055), kodi funksional (0980), fondi burimor (10), nga projektet: **Ndërtimi i shkollës ne Reti** kodi (46534), shuma prej 31,987.40 €, dhe **Riparimet ne shkolla** kodi (40870), shuma prej 16,747.75 €,
 - 3.1.1 Të rialokohen në projektin: **Ndërtimi çerdhes ne Ratkoc** kodi i projektit (45787), shuma prej 48,735.15 €.
4. **Nga mjetet e mbetura nga kategoria Rezerva, transferohen në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale, në shumë prej 10,000.00 € fondi burimor (10):**
 - 4.1 Brenda programit Planifikim Urban dhe Mjedisi (660), nën programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66360), kodi funksional (0620), fondi burimor (10), nga Kategoria: **Rezerva**, shuma prej 10,000.00 €,

4.1.1 Të transferohen në programin Planifikim Urban dhe Mjedisi (660), nën programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66360), kodi funksional (0620), fondi burimor (10) në projektin: **Krijimi i hapësirave të gjelbëruara dhe drunj dekorativë** kodi i projektit (47914), shuma prej 10,000.00 €.

5. Nga mjetet e mbetura nga kategoria Rezerva, transferohen në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale, në shumë prej 20,000.00 € fondi burimor (21)

5.1 Nga programi Planifikim Urban dhe Mjedisi (660), nën programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66360), kodi funksional (0620), fondi burimor (10), nga Kategoria: **Rezerva**, shuma prej 20,000.00 €,

5.1.1 Të transferohen në programin Planifikim Urban dhe Mjedisi (660), nën programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66360), kodi funksional (0620), fondi burimor (21) në projektin: **Krijimi i hapësirave të gjelbëruara dhe drunj dekorativë** kodi i projektit (47914), shuma prej 20,000.00 €

6. Bartës për rregullimin e dokumentacionit do të jetë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

7. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.382/22
Me datë: 28.10.2022

